



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES**

V E N D I M

Nr.25, datë 23.07.2019

Për

**“SHTYRJEN E AFATIT TË KËSHILLIMIT PUBLIK PËR
DOKUMENTIN: “RREGULLORE PËR MBROJTJEN E KONSUMATORËVE DHE
PËRDORUESVE TË SHËRBIMEVE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE
PUBLIKE””**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

-	Z. Ilir	Zela	Kryetar
-	Znj. Ketrin	Topçiu	Anëtare
-	Znj. Xhoana	Lilaj	Anëtare

dhe sekretare Znj. Hasime Ferati, në mbledhjen e datës 23.07.2019 sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullore e Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare” miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

- *Shtyrjen e afatit të këshillimit publik për dokumentin: "Rregullore për mbrojtjen e konsumatorëve dhe përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike"*

BAZA LIGJORE:

1. Neni 110 i Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (*ligji nr. 9918/2008*);
2. Ligji nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, (*ligji nr. 44/2015*);
3. Udhëzues për Procedurat e Keshillimit me Publikun miratuar me VKD nr.1183, datë 10.03.2010.

4. Vendimi i Këshillit Drejtues të AKEP me Nr.20, datë 22.05.2019 për “Miratimin për këshillim publik të dokumentit: "Rregullore për mbrojtjen e konsumatorëve dhe përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor,

- Shkresa e përbashkët me nr.1467/5 Prot., datë 18.07.2019 e Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Albtelecom: *Kërkesë për shtyrje të afatit të Konsultimit Publik të Rregullores "Për mbrojtjen e konsumatorëve dhe përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”*
- Relacioni shoqëruar i projektaktit miratues (Relacioni)
- Projektakti miratues i dokumentit (projektvendimi);

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. Këshilli Drejtues i AKEP me Vendimin nr.20, datë 22.05.2019, miratoi nxjerrjen në këshillim publik të dokumentit: "Rregullore për mbrojtjen e konsumatorëve dhe përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”. Proçedura e këshillimit publik u përcaktua që të kryhet për një periudhë 45 ditë nga data e publikimit të dokumentit në faqen e Internetit të AKEP. Dokumenti "Rregullore për mbrojtjen e konsumatorëve dhe përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike-këshillim publik” u publikua në faqen e Internetit të AKEP më datë 11.06.2019 dhe afati për dorëzimin e komenteve është data 26.07.2019.
2. Sipërmarrësit e rrjeteve celulare, Vodafone Albania sh.a, Telekom Albania sh.a, dhe Albtelecom sh.a, nëpërmjet një shkrese të përbashkët të depozituar në AKEP me nr.1467/5 Prot., datë 18.07.2019 (ref.Vodafone Albania CEO/011/KQ, datë 15.07.2019, Ref.Telekom Albania Nr.3735, datë 15.07.2019, Ref.Albtelecom Nr.5288, datë 17.07.2019) kanë bërë kërkesë për shtyrje të afatit të konsultimit publik të rregullores "Për mbrojtjen e konsumatorëve dhe përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”. Në këtë kërkesë tre operatorët celularë shprehen se:
 - Dokumenti për Këshillim Publik nëpërmjet propozimit të disa proceseve të reja si edhe ndryshimit të rregullimeve ekzistuese, prek një spekter të gjere çështjesh të cilat kërkojnë një analizë të thelluar nga disa prej nga departamenteve të tyre të brendshme. Koordinimi i punës për dorëzimin e komenteve të plota brenda afatit të parashikuar, në një periudhë kohore që perkon me marrjen e pushimeve të planifikuara të periudhës së verës ka rezultuar të jetë shumë i vështirë.
 - Duke konsideruar rëndesinë e kesaj rregulloreje, nevojitet me tepër kohë për vlerësimin e impaktit të mundshëm për operatorët si në aspektin teknik, ashtu edhe në atë procedural, komercial dhe financiar.

Për sa më sipër, tre operatorët celularë kërkojnë shtyrjen e afatit të paraqitjes së komenteve për datën 9 Shtator 2019.

3. AKEP, duke marrë në konsideratë se dokumenti i nxjerrë në këshillim publik "Rregullore për mbrojtjen e konsumatorëve dhe përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike" përmban një sërë elementësh të rinj në kuadrin rregullator për mbrojtjen e konsumatorit si dhe konsolidimin e tre akteve në një të vetëm, si dhe periudha e këshillimit publik përkon me procese të tjera të rëndësishme si zbatimi i vendimeve për rregullimin e roamingut ndërkombëtar me Kosovën dhe Ballkanin Perëndimor, vlerëson të arsyeshme argumentat dhe kërkesën e tre operatorëve celularë për shtyrje të afatit të këshillimit publik.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e procesit të këshillimit publik për dokumentin "Rregullore për mbrojtjen e konsumatorëve dhe përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike", bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918/2008,, Këshilli Drejtues i AKEP

V E N D O S I:

1. Të pranojë kërkesën e sipërmarrësëve të rrjeteve celulare, Vodafone Albania sh.a, Telekom Albania sh.a, dhe Albtelecom sh.a, të depozituar në AKEP me shkresën me nr.1467/5 Prot., datë 18.07.2019, për shtyrje të afatit të procesit të këshillimit publik të dokumentit "Rregullore për mbrojtjen e konsumatorëve dhe përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike".
2. Proçedura e këshillimit publik të dokumentit "*Rregullore për mbrojtjen e konsumatorëve dhe përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike*", miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP me Nr.20, Datë 22.05.2019, të zgjatet deri më datë 13 Shtator 2019.
3. Ky Vendim të publikohet në faqen zyrtare të internetit të AKEP: www.akep.al.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

KRYETAR

Ilir Zela

ANËTAR

Ketrin Topçiu

ANËTAR

Xhoana Lilaj